


### RINIA VLERËSON STRATEGINË KOMBËTARE TË RINISË 2022-2029 DHE IMPAKTIN E SAJ NË JETËN E PËRDITSHME

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët së bashku me 140 të rinj nga 59 Këshilla Vendorë Rinorë, Ekipin e Rinisë dhe përfaqësues nga Unicef e World Vision Albania, njëkohësisht partnerë dhe mbështetës për strategjinë, u mblodhën së bashku në kampin dy ditor "Rinia Vlerëson", ku kanë diskutuar dhe marrë një vlerësim të jashtëm nga ekspertë të fushës dhe të rinjtë që përfitojnë drejtpërdrejtë nga strategjia 8 vjeçare për rininë, për masat e ndërmarra dhe impaktin e tyre në qytetet respektive të të rinjve. Gjatë kampit dy ditor, të rinjtë kanë ndarë eksperiencat e tyre si anëtarë të KVR-ve, duke shkëmbyer dhe marrë ide të reja për t'i implementuar në qytetet e tyre. Në përfundim të sesioneve dhe bisedimeve me panelistët e ftuar, të rinjtë plotësuan pyetësorin për vlerësimin e jashtëm të SKR29, që ndihmon për të kuptuar më shumë rreth zbatimit të suksesshëm të strategjisë në nivel kapilar. Të gjithë së bashku do të vijnë të vlerësojnë periodikisht strategjinë dhe impaktin e saj në jetën e përditshme, duke shënuar një tjetër hap të rëndësishëm në mbarëvajtjen e Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022-2029 dhe vlerësimin e vazhdueshëm të impaktit të saj.



### ZHVILLOHET PANAIRI I PARË I PUNËS NË QARKUN E KUKËSIT

Panairi i parë për edukim, arsim dhe punësim për të rinjtë e Qarkut Kukës, u realizua nga Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët në bashkëpunim me projektin britanik "Perspektiva të Reja" me mbështetjen e Bashkisë Kukës, dhe me pjesëmarrjen e 27 institucioneve, bizneseve e organizatave, që njohën të rinjtë me mundësitë që ata ofrojnë për edukim, arsim dhe punësim në qytetin e tyre apo edhe në qytete të tjera. Të rinjtë, gjatë panairit u informuan më shumë rreth mundësive për arsimim për të zhvilluar njohuritë e tyre dhe mundësitë për të hedhur hapat e parë drejt karrierës së tyre, apo edhe për ta zhvilluar më tej atë. Ndër të tjera, u informuan mbi pozicionet vakante të bizneseve kryesore në zonë si bujqësia, aeroporti etj.

### NËNSHKRUHET MEMORANDUMI I BASHKËPUNIMIT ME WORLD VISION ALBANIA

Në kuadër të rritjes së bashkëpunimeve për të krijuar gjithmonë e më shumë mundësi dhe shërbime ë për të rinjtë, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët ka nënshkruar Memorandumin e Bashkëpunimit me Znj. Eljona Elmazi, Drejtoreshë Ekzekutive e World Vision Albania duke konkretizuar kështu bashkëpunimin e ngushtë 2-vjeçar midis dy institucioneve me fokus rininë dhe fuqizimin e tyre në të gjitha aspektet e mirëqenies sociale. Në vijim të bashkëpunimit midis dy institucioneve, me anë të Memorandumit të Bashkëpunimit do të mbështeten të rinj në të gjithë Shqipërinë për të ngritur rrënjë të forta shoqërie dhe ndërveprimi mes të rinjve.





### MBAHET TAKIMI I 19-TË I BORDIT DREJTUES TË RYC

Në kuadër të takimit të radhës të bordit drejtues të Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor (RYCO), në statusin e përfaqësuesit të Qeverisë Shqiptare, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët mirëpriti në Tiranë përfaqësues të shteteve të Ballkanit Perëndimor dhe përfaqësues rinor, për të diskutuar rreth ecurisë, impaktit dhe ndryshimeve pozitive në RYCO. Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët drejtoi mbledhjen e RYCO së bashku me përfaqësuesin rinor të Shqipërisë, Klajdi Priska. Në një mbledhje konstruktive, që zgjati rreth 10 orë, u diskutuan dhe u morën vendime për politikat e përbashkëta që vendet e Ballkanit Perëndimor zhvillojnë për fuqizimin e të rinjve në rajon.

Gjithashtu, u festua 7 vjetori i rithemelimit të RYCO, dhe u rihap thirrja për projekte rinore në Ballkanin Perëndimor me titull "Reconnecting Youth", e cila do të jetë e hapur për organizatat rinore dhe për të rinjtë deri më 15 gusht 2023.

### FINALIZOHET NJË NGA PROJEKTET FITUES NGA THIRRJA E DYTË E AGJENCISË KOMBËTARE TË RINISË, "ZHVILLIMI I KOMPETENCAVE MIDIS TË RINJVE DHE SIPËRMARRËSVE TË SHEKULLIT XXI NË SHQIPËRI"

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët mori pjesë në ceremoninë e diplomimit të të rinjve pjesë e projektit të ASDO, që ka përfshirë 210 të rinj të cilët kanë përvetësuar aftësi të reja teknologjike në përputhje me zhvillimet e vullshme të tregut digjital. 11 prej të rinjve u diplomuan dhe certifikuan në GIS, program që përdoret për të përpunuar të dhëna satelitore, ndërsa të rinjtë e tjerë u diplomuan në Python, Java dhe Web Development. Ndërkohë, projektet e tjera fituese nga Thirrja e Dytë vijojnë të zbatohen për të fuqizuar të rinjtë në të gjithë Shqipërinë dhe vijonë procedurat për Thirrjen e Tretë të Agjencisë Kombëtare të Rinisë.

"Zhvillimi i kompetencave midis të rinjve dhe sipërmarrësve të shekullit XXI në Shqipëri" është një nga projektet fituese nga Thirrja e Dytë e Agjencisë Kombëtare të Rinisë, i zbatuar po me mbështetjen e AKR-së.



### "EJA LUAJMË NË PAZAR" ME SPECIAL OLYMPICS ALBANIA

Special Olympics Albania çeli edicionin e tretë të lojrave "Eja luajmë në pazar", ku sheshi i pazarit u vendos në dispozicion të plotë të fëmijëve dhe të rinjve me plot aktivitete sportive. Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët u bashkua në këtë aktivitet, ku fëmijëve nën kujdesin e trajnerëve iu ofruan lojra nga më të ndryshmet si joga, futboll, basketboll, tenis, badminton, me mesazhin kryesor për gjithëpërfshirje "Sport për të gjithë", duke u krijuar mundësi të gjithëve zhvillojnë aftësi fizike, të krijojnë eksperiencë, të përmirësojnë shëndetin e tyre dhe të integrohen me partnerët, familjet dhe komunitetin.

Mbështetja për organizatat sportive që kanë në fokus sportin gjithëpërfshirës është dhe do vijojë të jetë një nga prioritetet e Ministrisë së Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, me qëllim krijimin e një brezi të ri të shëndetshëm dhe që sportin e ka pjesë të jetës.



### MONITORIMI I PROGRAMIT TË KODIMIT ME MBËSHTETJE FINANCIARE NGA QEVERIA NË AKADEMINË E KODIMIT "HOLBERTON"

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët iu bashkua një prej akademive të kodimit, Holberton, që ofron kurse programimi për të rinjtë 16 vjeç e sipër, me mbështetjen e qeverisë shqiptare, për të diskutuar dhe kuptuar progresin e gjeneratës së parë të programuesve nga kjo akademi. Të rinjtë që ende nuk janë diplomuar nga akademja, ndanë eksperiencat e tyre gjatë kursit për themelet e programimit, duke shtuar se tashmë një pjesë e mirë e tyre kishin filluar punët e para në distancë për vende të ndryshme të botës, duke fituar paga të denja.

Gjatë kësaj vizite, një i ftuar i veçantë nga Silicon Valley, San Francisco kishte një sesion informues me të rinjtë, Z. Frank Hysa, Drejtori i Inovacionit pranë Capgemini, u tregoi të rinjve mbi eksperiencën e tij si një shqiptar në drejtim të një nga shoqërive më të suksesshme në fushën e teknologjisë, si dhe ndau të rejat e fundit në inteligjencën artificiale, si dhe u sugjeroi të rinjve të përqëndronin zhvillimin e njohurive të tyre në këtë fushë, si fusha e së ardhmes.

Ndërkohë, Programi i Kodimit, që ofrohet me mbështetje financiare nga qeveria në masën 50% për studentët dhe të punësuarit, dhe në masën 100% për punëkërkesit e papunë, vijon të jetë i hapur për të gjithë të interesuarit. Aplikimet vijnë ende në portalin e-Albania në shërbimin "Aplikim për kursin e formimit profesional me mbështetje financiare nga qeveria".



### SHKËMBIME MES TË RINJVE TË SHKOLLAVE TË MESME ME ATA TË BALLKANIT PERËNDIMOR NË KUADËR TË PROGRAMIT "SUPERSHKOLLAT"

Një nga programet që zbatohen nga RYCO, është programi Supershollat, ku qëllimi është shkëmbimi midis të rinjve të shkollave të mesme në Ballkanin Perëndimor, për të ndarë eksperiencat e tyre dhe për të zhvilluar njohuritë mbi rajonin. Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, së bashku me Ambasadorin Gjerman Z. Peter Zingraf dhe përfaqësues nga Delegacioni i BE-së, Z. Alexis Hupin iu bashkua të rinjve të shkollës "Hydajet Lezha" të Lezhës, dhe të shkollës "Miloš Crnjanski" të Serbisë, që sapo kishin kryer vizitën e tyre në Shqipëri, ku për dy javë kishin ndarë kohë me të rinjtë e Lezhës. Në shtator nxënësit e Lezhës do mund të vizitojnë miqtë e tyre të rinj nga shkolla "Miloš Crnjanski" në Kikinda të Serbisë, për të përmbyllur me sukses shkëmbimin e tyre dypalësh.

Gjatë vitit 2023, me programin "Supershollat", do të kryejnë shkëmbime 18 shkolla nga Shqipëria, me vendet e Ballkanit Perëndimor duke përfshirë Kosovën, Bosnje Hercegovinën, Serbinë, Malin e Zi, dhe Maqedoninë e Veriut.

